697	ISAK	HYSEN	CENAJ	120	2315	28/120	114.6	3,500	401,240	Lagja nr-2
698	MUSTAFA	HYSEN	CENAJ							
700	GANI	HYSEN	CENAJ							
701	AVDYL	HYSEN	CENAJ							
							<b>140.5</b>	<b>shuma</b>	<b>466,095</b>	
<b>QARKU DIBËR</b>										
702	SHUIP	HYSNI	VLESHA	121	2932	23/109	98.2	10,000	982,000	Lagja Gjok Doci
703	FIQIRETE	HYSNI	VLESHA							
704	SELAMI	HYSNI	VLESHA							
705	VJOLLCA	HYSNI	VLESHA							
706	ARBEN	HYSNI	VLESHA							
708	MEVLUDE	HYSNI	VLESHA							
709	SILVANA	AGIM	VLESHA							
710	EDLIRA	AGIM	VLESHA							
711	ERGINJO	AGIM	VLESHA							
712	BUKURIE	AGIM	VLESHA							

713	ELMAZ	SULEJMAN	ELMAZI	122	2932	7/95	464.5	11,000	5,109,060	Lagja Nazmi Rushiti
714	DRITA	SULEJMAN	ELMAZI							
716	PELLUMB	SULEJMAN	ELMAZI							
717	MEVLUDE	SULEJMAN	ELMAZI							
718	LULE	SHYQIRI	ELMAZI							
719	DIANA	SHYQIRI	ELMAZI							
720	GEZIM	SHYQIRI	ELMAZI							
721	ARDITA	PERPARIM	ELMAZI							
722	ANDI	PERPARIM	ELMAZI							
							<b>562.7</b>	<b>shuma</b>	<b>6,091,060</b>	
<b>QARKU VLORE</b>										
724	FREDERIK	FASLLI	HAMITAJ	123	8601	16/54	285.0	11,000	3,135,000	Lagja H. CAKERRI
725	BASHKËPRONËSI	AGALLIU		124	8605	16/5	500.0	10,000	5,000,000	Lagja "24 Maji"
							<b>785.0</b>	<b>shuma</b>	<b>8,135,000</b>	
<b>QARKU GJIROKASTËR</b>										
726	JANI	MIHAL	JOVANI	125	2007	34/52	29.7	1,466	43,540	K.Dropull i Sipërm, F.Jorgucat
727	THODHORI	SOTIR	BEÇI	126	2007	34/51	74.3	1,466	108,924	K.Dropull i Sipërm, F.Jorgucat
728	VANGJEL	DHIMITER	PAPA	127	2007	34/49	142.0	1,466	208,172	K.Dropull i Sipërm, F.Jorgucat
							<b>246.0</b>	<b>shuma</b>	<b>360,636</b>	

m<sup>2</sup> **43,196.1** SHUMA TOTALE **410,676,127** lekë



**UDHËZIM**  
**Nr.906, datë 21.11.2011**

**PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.529, DATË 8.6.2011**  
**“PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURËS DHE TË MËNYRËS SË**  
**DHËNIES ME QIRA, ENFITEOZË APO KONTRATA TË TJERA TË PASURISË**  
**SHTETËRORE”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të kapitullit IX të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.529, datë 8.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

**UDHËZON:**

1. Procedurat e konkurrimit për dhënie me qira ose enfiteozë të pronës shtetërore kryhen prej organit që ka të drejtën e lidhjes së kontratës së qirasë ose enfiteozës.

2. Në zbatim të pikës 2 dhe pikës 5-b të kreut I të vendimit, dhënia me qira e makinerive e pajisjeve, në të gjitha rastet e lidhjes së kontratave, bëhet nga njësia që ka në administrim objektin e kontratës së qirasë, e cila përcakton vlerën e qirasë mujore për çdo vit, sipas përcaktimeve në pikën 3 të kreut III “Tarifat dhe vlera dysheme për pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiteozë” të këtij vendimi.

3. Në zbatim të pikës 5-c të kreut I të vendimit, institucioni që ka në administrim objektet e dhëna me leje shfrytëzimi të pasurive minerare, peshkimit, ujërave etj., dhe asetet që kërkohen me qira në ndihmë të aktivitetit të lejes përkatëse, plotëson dokumentacionin për dhënie me qira të aseteve, sipas pikës 1, në kreun II, të vendimit të cituar dhe e përcjell në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së bashku me projektkontratën. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës shqyrton dokumentacionin dhe autorizon në emër dhe për llogari të saj, së bashku me projektkontratën, institucionin që monitoron lejen e shfrytëzimit, për të lidhur kontratën e qirasë. Kontrata e qirasë lidhet për periudhë jo më të gjatë se afati i lejes së dhënë. Në kontratën e qirasë nuk përfshihet sipërfaqja e dhënë me leje shfrytëzimi, por sipërfaqet dhe objektet në ndihmë të ushtrimit të veprimtarisë për të cilën është licencuar.

4. Në zbatim të pikës 5-ç të kreut I të vendimit, subjekti paraqet në METE kërkesën për kontratë huapërdorjeje për sipërfaqen e ndërtimit të fabrikave, të konfirmuar në biznesplanin e paraqitur për marrjen e lejes së shfrytëzimit, të shoqëruar me dokumentacionin si vijon:

- Lejen për ndërtimin e fabrikës të lëshuar nga organi që e ka në kompetencë.

- Genplanin e sipërfaqes ku do të ndërtohet fabrika, të përgatitur sipas pikës 1-ç të kreut II të vendimit.

- Kopje të noterizuara të lejes së shfrytëzimit, të marrëveshjes minerare dhe biznesplanit.

5. Në zbatim të pikës 5-d të kreut I, zgjatja e marrëdhënieve kontraktore për kontratat e qirasë të lidhura pa konkurrim dhe për objekte me sipërfaqe të përgjithshme mbi 500 m<sup>2</sup>, bëhet vetëm një herë dhe afati në total i kontratës nuk duhet të kalojë afatet e përcaktuara në pikën 6 të kreut I të vendimit të cituar. Zgjatja e marrëdhënieve bëhet me kërkesë të subjektit qiramarrës. Njësia që ka në administrim objektin përgatit genplanin e tij sipas pikës 1-ç të kreut II të vendimit dhe e dërgon në organin që ka lidhur kontratën e qirasë. Për afatin e ri, vlera e detyrimit mujor të qirasë do të aplikohet referuar tarifave dysheme të përcaktuara në kreun II të vendimit të cituar, duke përfutur edhe përqindjen e uljes për treguesin e investimit, në rastet kur subjekti e ka përfutur këtë të drejtë.

6. Në zbatim të pikës 5-dh të kreut I, në kontratat për dhënien me qira të objekteve shtetërore për institucionet shtetërore, shoqëritë tregtare apo ish-ndërmarrjet lidhen nga institucioni, shoqëria apo ish-ndërmarrja që i administron ato, me afat jo më shumë se 5 vjet. Në këto raste, dokumentacioni përgatitet sipas pikës 1 të kreut II të vendimit dhe vlera e detyrimit mujor të qirasë aplikohet referuar tarifave dysHEME të përcaktuara në kreun II të vendimit të cituar.

7. Në zbatim të pikës 8 të kreut I, për kontratat me afat mbi 1 vit, vlera dysHEME e detyrimit mujor të qirasë do të llogaritet duke aplikuar tarifat e përcaktuara në kreun III të vendimit të cituar.

8. Në zbatim të pikës 1-c të kreut III, me termin “truall të lirë” do të kuptohen rastet kur sipërfaqja është shesh i lirë dhe nuk është pjesë funksionale e ndonjë objekti ndërtimor.

9. Në zbatim të pikave të kapitullit IV “Nxitja e biznesit”, për përfitimin e zbritjes së detyrimit mujor të qirasë, qiramarrësi ose enfiteozëmarrësi i paraqet qiradhënësit kërkesë të shoqëruar me dokumentacionin:

a) Vërtetim për punësimin mesatar vjetor të realizuar në vitin përkatës, të lëshuar nga institucionet shtetërore përkatëse.

b) Raport i ekspertit kontabël për investimet e realizuara nga qiramarrësi ose enfiteozëmarrësi në objektin e marrë me qira dhe të paraqitura në bilancet financiare të asaj shoqërie.

c) Bilancin financiar të shoqërisë qiramarrëse ose enfiteozëmarrëse për vitin përkatës.

Zbritja e detyrimit mujor për nivelin e punësimit të realizuar mbrohet çdo vit nga qiramarrësi ose enfiteozëmarrësi, me dokumentacionin përkatës, ndërsa zbritja e detyrimit mujor për nivelin e investimit të realizuar vlen deri në përfundim të kontratës. Kur niveli i punësimit ndryshon nga viti paraardhës dhe përfshihet në grup tjetër, miratohet koeficienti zbritës i ri sipas akteve ligjore në fuqi në atë moment.

10. Në zbatim të pikës 1 të kapitullit IV të vendimit, procedohet si vijon:

Organi që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit, pasi shqyrton propozimet e përgatitura sipas pikës 1 në kapitullin II të këtij vendimi, i propozon Këshillit të Ministrave për rastet kur është me interes të alikohet kontrata me tarifën 1 euro kontrata, për ushtrim të aktivitetit prodhues. Me daljen e vendimit të Këshillit të Ministrave për kontratë me tarifën 1 euro kontrata, organi që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit fillon procedurat sipas pikave të tjera në kapitullin II të vendimit të cituar dhe kriterëve të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave të mësipërm.

11. Në zbatim të pikës 2-c të kapitullit VI të vendimit, njësitë monitoruese:

- monitorojnë në vijueshmëri aktivitetin që ushtron subjekti qiramarrës ose enfiteozëmarrës, në objektin e marrë me qira, në respektim të qëllimit të lidhjes së kontratës;

- monitorojnë për çdo muaj, që subjektet qiramarrëse ose enfiteozëmarrëse të derdhin në afatin e përcaktuar në kontratë detyrimin mujor të qirasë;

- bëjnë përlllogaritjen e kamatëvonesave dhe ndjekin derdhjen e tyre sipas rregullave financiare;

- monitorojnë respektimin e kushteve të kontratës për investimet që kryhen në objektin e marrë me qira ose enfiteozë;

- monitorojnë respektimin e kushteve të kontratës për numrin e të punësuarëve në objektin e marrë me qira ose enfiteozë;

- zgjidhin problemet që lindin gjatë kohës që është në fuqi kontrata, për të cilat është përgjegjëse njësia që ka në administrim objektin;

- hartojnë çdo tre muaj akte rakordimi me subjektet qiramarrëse ose enfiteozëmarrëse për realizimin e kushteve të kontratës: derdhjen e detyrimeve mujore dhe kamatëvonesave, punësimin e realizuar në objektin e marrë me qira dhe investimet që kryhen subjekti qiramarrës ose enfiteozëmarrës dhe një kopje e përcjellin në institucionin që ka firmosur kontratën e qirasë.



12. Në zbatim të kapitullit VIII “Vlefshmëria e kontratave”, paragrafi i fundit në pikën 4, pagesa e ekspertëve të miratuar në vlerën 100 000 (një qind mijë) lekë për çdo ekspert, urdhërohet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, pasi miraton raportin e tyre.

13. Në zbatim të kapitullit VIII “Vlefshmëria e kontratave”, paragrafi i fundit në pikën 4, pagesa e ekspertëve të miratuar në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë për çdo ekspert, urdhërohet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, pasi miraton raportin e tyre.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË  
DHE ENERGJETIKËS  
Nasip Naço

**URDHËR**  
**Nr.5949/5, datë 29.12.2011**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E  
KOMISIONIT DISIPLINOR TË PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË” DHE  
PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË TIJ**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të nenit 7 të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të nenit 51 të ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbarrimor gjyqësor privat”,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e rregullore “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Disiplinor të Përmbarruesve Gjyqësorë Privatë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Masa e shpërblimit të anëtarëve të Komisionit Disiplinor është 10 000 (dhjetë mijë) lekë për çdo mbledhje. Masa e shpërblimit mbulohet nga llogaria e Dhomës Kombëtare të Përmbarruesve Gjyqësorë Privatë.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Përmbarruesve Gjyqësorë Privatë dhe Dhoma Kombëtare e Avokatëve.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË  
Eduard Halimi

**RREGULLORE**  
**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT DISIPLINOR TË  
PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË**

**Neni 1**  
**Objekti**

1. Kjo rregullore ka për objekt përcaktimin e rregullave lidhur me ushtrimin e veprimtarisë dhe funksionimit të Komisionit Disiplinor të Përmbarruesve Gjyqësorë Privatë, në vijim “Komisioni”.



Neni 2  
**Misioni i Komisionit**

1. Komisioni krijohet me urdhër nga Ministri i Drejtësisë dhe ka për mision kryerjen e shqyrtimit të procedimit disiplinor ndaj përmbauesve gjyqësorë privatë, në përputhje me dispozitat e kreut IX “Procedimi disiplinor” të ligjit nr.10 031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbauesor gjyqësor privat”.

Neni 3  
**Përbërja e Komisionit**

1. Komisioni përbëhet nga tre anëtarë:
- Kryetari i Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë, ose një përfaqësues i autorizuar prej tij, në cilësinë e kryetarit;
  - Kryetari i Këshillit Drejtues të Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Privatë, në cilësinë e anëtarit;
  - Një avokat i caktuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatëve, në cilësinë e anëtarit.

Neni 4  
**Detyrat e kryetarit dhe anëtarit të Komisionit**

1. Kryetari i Komisionit kryen këto detyra:
- drejton mbledhjen duke siguruar mbarëvajtjen e saj në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje;
  - cakton rendin e ditës sipas kërkesave për procedim disiplinor të paraqitura nga Ministri i Drejtësisë;
  - cakton dhe njofton kohën dhe vendin e mbledhjes brenda datës së kërkuar dhe merr konfirmimin me shkrim të anëtarëve të Komisionit, përmbauesit gjyqësor privat ndaj të cilit zhvillohet procedimi dhe personave të tjerë të interesuar, të cilët do të jenë pjesëmarrës në mbledhje;
  - paraqet materialin e nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes para anëtarëve dhe e dërgon njëkohësisht në drejtim të përmbauesit gjyqësor privat, ndaj të cilit zhvillohet procedimi dhe personave të interesuar, brenda 3 ditëve para datës së përcaktuar për mbledhjen;
  - kujdeset për ndjekjen e procedurës së Komisionit gjatë shqyrtimit të shkeljes disiplinore, duke dhënë të drejtën e fjalës dhe duke ngritur çështje për diskutim;
  - administron materialet e nevojshme, të cilat kërkohen nga anëtarët e tjerë;
  - kryen ballafaqimet dhe saktësimet e kërkuara nga anëtarët e Komisionit, si dhe njofton mbylljen e diskutimeve.
2. Anëtari i Komisionit kryen këto detyra:
- përcjell konfirmimin me shkrim të kryetarit të Komisionit për pjesëmarrjen në mbledhjen e radhës;
  - përgatit me shkrim materialin e nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes dhe e përcjell te kryetari i Komisionit me qëllim shpërndarjen e tij tek anëtarët e tjerë të Komisionit;
  - ruan të dhënat me të cilat është njohur gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij dhe që përbëjnë sekret profesional.



## Neni 5 Mbledhja e Komisionit

1. Komisioni mblidhet brenda 10 ditëve nga paraqitja e kërkesës së Ministrit të Drejtësisë për nisjen e procedimit disiplinor.
2. Gjatë mbledhjes mbahet procesverbali nga njëri prej anëtarëve i caktuar me vendim të Komisionit, në të cilin pasqyrohet çdo element i zhvillimit të mbledhjes dhe vendimet e marra nga Komisioni. Procesverbali mbledhjes nënshkruhet në fund prej të gjithë anëtarëve të Komisionit.
3. Një kopje e procesverbalit të mbledhjes dhe çdo material tjetër të administruar gjatë zhvillimit të saj depozitohen pranë Ministrit të Drejtësisë, brenda 5 ditëve nga përfundimi i mbledhjes, përveçse kur në këtë rregullore përcaktohet afat i ndryshëm.

## Neni 6 Marrja e vendimeve nga Komisioni

1. Mbledhja e Komisionit është e vlefshme kur në të marrin pjesë të gjithë anëtarët e tij. Kur mungon njëri prej anëtarëve caktohet një datë tjetër për zhvillimin e mbledhjes, brenda 3 ditëve pune. Çdo ndryshim për datën e mbledhjes i njoftohet, pa vonesë, çdo anëtar.
2. Komisioni merr vendime vetëm për çështje, të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes.
3. Marrja e vendimeve në mbledhjen e Komisionit bëhet me votim, i cili është individual dhe i hapur. Secili prej anëtarëve ka të drejtën e ushtrimit të një vote. E drejta e votës nuk mund t'i delegohet në asnjë rast ndonjë anëtar të Komisionit.
4. Votat e anëtarëve të Komisionit regjistrohen në procesverbalin e mbledhjes. Kur një anëtar voton kundër kjo argumentohet me shkrim dhe i bashkëngjitet procesverbalit të mbledhjes.
5. Asnjë prej anëtarëve të Komisionit nuk mund të abstenojë në marrjen e vendimeve.

## Neni 7 Fillimi i procedimit disiplinor

1. Ministri i Drejtësisë, me nismën e tij ose sipas ankesës së paraqitur nga palët në proces ekzekutimi, duke u bazuar në rezultatet e inspektimit, ndërmerr nismën e fillimit të procedimit disiplinor, duke ia kaluar materialet përkatëse me shkrim Komisionit.
2. Procedimi disiplinor kundër përmbaruesit gjyqësor privat mund të fillojë kur konstatohen shkelje të detyrës apo veprime të parregullta gjatë ushtrimit të veprimtarisë së përmbaruesit gjyqësor privat.
3. Procedimi disiplinor kundër përmbaruesit gjyqësor privat vazhdon edhe në rast se pala në proces ekzekutimi tërheq ankimin dhe gjatë verifikimit janë konstatuar shkelje të detyrës apo veprime të parregullta të kryera gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

## Neni 8 Shqyrtimi i shkeljes disiplinore

1. Komisioni në çdo rast i garanton përmbaruesit gjyqësor privat të drejtën për t'u informuar, dëgjuar dhe mbrojtur.
2. Sqarimet rreth shkeljes së pretenduar, përmbaruesi gjyqësor privat mund t'i paraqesë me gojë dhe me shkrim, vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit ligjor të tij.

3. Kryetari i Komisionit pas çdo mbledhjeje informon me shkrim Ministrin e Drejtësisë në lidhje me zhvillimin dhe ecurinë e mbledhjes së Komisionit, duke i dërguar edhe kopje të procesverbalit të mbledhjes brenda afatit të përcaktuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje.

#### Neni 9

##### **Shqyrtimi në mungesë dhe ndërprerja**

1. Komisioni, kur konstaton se përmbaruesi gjyqësor, i njoftuar rregullisht, nuk paraqitet në seancë dëgjimore për shkaqe të ligjshme, ndërpret shqyrtimin dhe cakton seancën e radhës brenda 15 ditëve.

2. Njoftimi drejtuar përmbaruesit për seancën e radhës përmban edhe të drejtën e caktimit të një përfaqësuesi nëse pengesa për paraqitjen e përmbaruesit në seancën e radhës vazhdon ende.

3. Nëse përmbaruesi gjyqësor nuk paraqitet në seancën e radhës, megjithëse është njoftuar rregullisht, Komisioni vazhdon shqyrtimin e shkeljes disiplinore.

4. Kur përmbaruesi gjyqësor privat kërkon gjatë seancës dëgjimore paraqitjen e provave të reja, me pretendimin se nuk ka pasur mundësi t'i paraqesë ato, Komisioni ndërpret shqyrtimin e masës dhe cakton seancën e radhës brenda 15 ditëve. Kjo ndërprerje vendoset vetëm njëherë.

#### Neni 10

##### **Konstatimi i shkeljes nga Komisioni**

1. Komisioni gjatë procedimit disiplinor vërteton nëse përmbaruesi gjyqësor:

a) ka shkelur në mënyrë të përsëritur rregullat ligjore e nënligjore, që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë së tij;

b) nuk ka përmbushur me faj veprimet përmbarimore, që kanë cenuar të drejtën e palëve në proces ekzekutimi;

c) nuk ka respektuar dispozitat e Kodit të Etikës së përmbaruesit gjyqësor privat;

ç) ka shkelur besimin e palës kontraktuese, nëpërmjet kryerjes së veprimeve korruptive me palën tjetër, për të mos ekzekutuar apo vonuar ekzekutimin e titullit ekzekutiv;

d) ka konflikt interesi në një procedurë ekzekutive;

dh) nuk ka evidentuar në mënyrë të rregullt të gjitha aktet dhe veprimet procedurale të kryera gjatë veprimtarisë së ekzekutimit;

e) ka shkelur kërkesat për konfidencialitetin, sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave që merr, si rezultat i ushtrimit të veprimtarisë së vet gjatë procedurës së ekzekutimit;

ë) ka refuzuar për të mos lejuar strukturat përgjegjëse shtetërore për të ushtruar kontroll ndaj veprimtarisë procedurale të tij.

#### Neni 11

##### **Përfundimi i procedimit disiplinor**

1. Komisioni, pasi ka përfunduar hetimin administrativ, i paraqet Ministrin të Drejtësisë raportin përfundimtar, së bashku me propozimin e tij për masë disiplinore mbi kërkesën e Ministrin për procedimin disiplinor. Raporti dhe materialet shoqëruese dërgohen te Ministri i Drejtësisë brenda 10 ditëve nga përfundimi i seancës dëgjimore.

2. Propozimi i paraqitur nga Komisioni për marrjen e masës disiplinore shoqërohet kurdoherë me raportin përfundimtar dhe materialet e nevojshme, në të cilin mbështetet propozimi për marrjen e masës dhe lloji i saj.



3. Raporti përfundimtar përmban të dhëna mbi: objektin e çështjes; referencat ligjore përkatëse ku mbështetet shqyrtimi i çështjes; metodologjinë e ndjekur për përpilimin e tij; faktet dhe rrethanat që vërtetojnë shkeljen; analizën ligjore të çështjes; konkluzionet dhe propozimin e Komisionit.

#### Neni 12

##### **Propozimi i masës disiplinore**

1. Për kryerjen e shkeljeve të parashikuara në nenin 10 të kësaj rregulloreje dhe të vërtetuara gjatë procedimit disiplinor, Komisioni i propozon Ministrin të Drejtësisë masat e mëposhtme disiplinore:

a) për shkeljen e përcaktuar në shkronjat “a”, “b”, dhe “ç”, heqje të licencës dhe çregjistrimin nga regjistri;

b) për shkeljen e përcaktuar në shkronjat “c”, “d” dhe “dh”, me gjobë nga 30 000 deri 50 000 lekë;

c) për shkeljen e përcaktuar në shkronjat “e” dhe “ë”, me pezullim të licencës nga tre muaj deri në dy vjet.

#### Neni 13

##### **Nxjerrja e urdhrin të Ministrin të Drejtësisë**

1. Ministri i Drejtësisë brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së raportit përfundimtar dhe propozimit të Komisionit nxjerr urdhrin për dhënien e masës disiplinore ndaj përmbaruesit gjyqësor privat.

2. Urdhri për dhënien e masës disiplinore jepet i arsyetuar dhe i njoftohet përmbaruesit gjyqësor privat me shkrim brenda 15 ditëve nga data e daljes së urdhrin të Ministrin të Drejtësisë.

3. Urdhri i Ministrin të Drejtësisë për dhënien e masës disiplinore, pas kalimit të afatit të ankimit ose kur lihet në fuqi nga gjykata, evidentohet në regjistrin e përmbaruesve gjyqësorë privatë.

#### Neni 14

##### **Ankimi i përmbaruesit gjyqësor privat**

1. Kundër vendimit të Ministrin të Drejtësisë përmbaruesi gjyqësor privat mund të bëjë ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

**VENDIM**  
**Nr.53, datë 22.12.2011**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	anëtar i “ “
Petrit Ploçi	anëtar i “ “
Vitore Tusha	anëtare e “ “
Sokol Berberi	anëtar i “ “
Admir Thanza	anëtar i “ “
Altina Xhoxhaj	anëtare e “ “

me sekretare Enina Mullaj, në datën 5.7.2011, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr.26 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** Taulant Mataj, përfaqësuar nga avokati Gëzim Allaraj, me akt përfaqësimi.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit të ndërmjetëm të datës 21.10.2010 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe vendimit nr.00-2010-1439, datë 25.11.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42/2, 131/f, 134/1/g dhe 142/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoji relatoren e çështjes, Altina Xhoxhaj, shqyrtoi çështjen mbi aktet dhe diskutoi për të në tërësi,

**VËREN:**

**I**

1. Kërkuesi është gjykuar nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal.

2. Në seancën gjyqësore të datës 21.10.2010, mbrojtësi i kërkuesit ka kërkuar para Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda shpalljen e moskompetencës lëndore të saj për gjykimin e kësaj çështjeje dhe dërgimin e akteve Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si gjykata kompetente.

3. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin e ndërmjetëm të datës 21.10.2010, ka vendosur rrëzimin e kërkesës.

4. Kundër këtij vendimi të ndërmjetëm ka bërë rekurs të drejtpërdrejtë në Gjykatën e Lartë mbrojtësi i kërkuesit.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, me vendimin nr.00-2010-1439, datë 25.11.2010, ka vendosur mospranimin e rekursit.

6. Me kërkesën e datës 29.4.2011, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës.

7. **Kërkuesi** pretendon se vendimet e mësipërme të gjykatave janë të papajtueshme me Kushtetutën dhe parashtrojnë në thelb këto shkaqe për shfuqizimin e tyre:



- i) Gjykatat kanë cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj. Bazuar në nenin 75 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), vepra penale për të cilën është akuzuar kërkuesi nuk është në kompetencë të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.
- ii) Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është i padrejtë dhe i paarsyetuar.
- iii) Gjykata e Lartë nuk i referohet nenit 431 të KPP-së si bazë ligjore, por i referohet nenit 433 të KPP-së.

## II

8. Gjykata vëren se, bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, individ mund t'i drejtohet kësaj Gjykate për gjykimin përfundimtar të pretendimeve të tij për cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte.

9. Gjykata ka vlerësuar se Kushtetuta duhet interpretuar në atë mënyrë që të ketë kuptimin më të arsyeshëm dhe të frytshëm të mundshëm. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor (*shih vendimin nr.28, datë 23.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Shterimi nënkupton që kërkuesi duhet t'i shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr.1, datë 25.1.2010 dhe nr.17, datë 16.5.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Gjykata vëren se, bazuar në nenin 431 të KPP-së, janë objekt rekursi të drejtpërdrejtë në Gjykatën e Lartë vendimet e gjykatave për mosmarrëveshjet lidhur me juridiksionin dhe kompetencat, si dhe rastet e veçanta të parashikuara me ligj. Bazuar në nenin 89 të KPP-së, ka mosmarrëveshje kompetencash, në çdo gjendje a shkallë të procedimit, kur dy a më shumë gjykata, në të njëjtën kohë, marrin ose nuk pranojnë të marrin për shqyrtim të njëjtën akuzë, që i atribuohet të njëjtë person. Për të pasur një mosmarrëveshje kompetencash nevojitet bashkekzistenca e vullneteve të kundërta të dy ose më shumë gjykatave për të marrë në shqyrtim ose për të refuzuar shqyrtimin e të njëjtës çështje, çka sjell si pasojë pezullimin e procedimeve.

11. Bazuar në nenin 90 të KPP-së, mosmarrëveshja mund të parashtrohet nga prokurori pranë njëres prej gjykatave në mosmarrëveshje ose nga i pandehuri dhe palët private. Gjykata thekson se përmbajtja e kësaj dispozite kërkon ekzistencën e një konflikti real dhe efektiv dhe jo një situatë konflikti potenciale të pretenduar nga njëra nga palët në proces. Në rast të parashtrimit të mosmarrëveshjes nga palët, gjykata bën një vlerësim në lidhje me kompetencën e saj, nga e cila rrjedh ose jo konflikti, dhe në rastin e parë ngre çështjen e mosmarrëveshjes dhe merr vendim me të cilin i dërgon aktet Gjykatës së Lartë për zgjidhjen e konfliktit, kurse në rastin e dytë, pra nëse vlerëson se nuk ndodhet para një mosmarrëveshjeje kompetencash, vazhdon gjykimin e çështjes dhe në këtë rast palëve u lind e drejta t'i drejtohen Gjykatës së Lartë me rekurs të drejtpërdrejtë në kuptim të nenit 431 të KPP-së. Pra, kusht i nevojshëm paraprak për të vënë në lëvizje një rekurs të drejtpërdrejtë është roli i gjyqtarit/gjykatës.

12. Nga rrethanat e çështjes konkrete rezultojnë se çështja penale në ngarkim të kërkuesit Taulant Mataj është gjykuar nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Në seancën gjyqësore të datës 21.10.2010 mbrojtësi i kërkuesit i është drejtuar gjykatës me kërkesë për shpalljen e moskompetencës së saj lëndore për gjykimin e çështjes penale në ngarkim të kërkuesit dhe dërgimin e akteve Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si gjykata kompetente. Kjo kërkesë e mbrojtësit të kërkuesit është rrëzuar nga gjykata me vendimin e ndërmjetëm të datës 21.10.2010. Në këto kushte, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me rekurs të drejtpërdrejtë për të kundërshtuar vendimin e ndërmjetëm të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Kolegji

Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, me vendimin nr.00-2010-1439, datë 25.11.2010, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi.

13. Bazuar në rrethanat e çështjes konkrete dhe në pretendimet e kërkuesit, Gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk rezultojnë ekzistojnë ndonjë mosmarrëveshje kompetencash mes gjykatave, rrethanë kjo ligjore që do të legjitimonte subjektet e gjykimit të ushtronin recurs të drejtpërdrejtë në Gjykatën e Lartë, në kuptim të nenit 431 të KPP-së. Gjykata thekson, megjithatë, se pretendimet e palëve në lidhje me kompetencën e gjykatës nuk i mënjanohen kontrollit të mëtejshëm gjyqësor, pasi një pretendim i tillë mund të paraqitet lirisht jo vetëm para gjykatës që shqyrton çështjen, por mund të parashtrohet më tej në gjykatat më të larta si shkak për apel apo për recurs.

Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet ligjore për t'iu drejtuar kësaj Gjykate në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

#### VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vitore Tusha, Petrit Pllloçi, Altina Xhoxhaj.

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo, Sokol Berberi, Admir Thanza.

#### VENDIM

**Nr.265, datë 30.11.2011**

#### **PËR DHËNIE LICENCE PËR RADION PRIVATE VENDORE “RADIO 7 NORD” SUBJEKTIT: SHOQËRIA “GOOD NEWS J-MEDIA” SHPK**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetimin radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, dhe rregullores “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010 të KKRT-së, pasi mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “Good News J-Media” sh.p.k., për t’u licencuar si operator radiofonik privat vendor, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

#### VENDOSI:

1. T’i japë shoqërisë “Good News J-Media” sh.p.k., licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik privat vendor, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për



një periudhë prej 3 (tre) vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence për të mbuluar me sinjal rrethin e Shkodrës.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifa.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**  
**Endira Bushati**

**VENDIM**  
**Nr.266, datë 30.11.2011**

**PËR ZGJERIM ZONE LICENCIMI PËR TELEVISIONIN PRIVAT VENDOR**  
**“UTV EDUCATION”**  
**SUBJEKTIT: SHOQËRIA “UTV EDUCATION” SHPK**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi kriteret për dhënie e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, miratuar me vendimin nr.355, datë 29.8.2005 dhe rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “UTV Education” sh.p.k., për zgjerimin e zonës së licencimit dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

**VENDOSI:**

1. Të miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të shoqërisë “UTV Education” sh.p.k., për televisionin privat vendor “UTV Education”, sipas licencës nr.009 TVL, në qarqet Elbasan-Korçë.

2. Karakteristikat teknike janë pjesë përbërëse e licencës përkatëse dhe u nënshtrohen të gjitha kushteve të saj.

3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse në licencën e subjektit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**  
**Endira Bushati**



**VENDIM**  
**Nr.267, datë 30.11.2011**

**PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN PRIVAT KABLLOR**  
**“TV KABLLOR ERGI”**  
**SUBJEKTIT PERSON FIZIK: ERJON KETA**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kablo”, miratuar me vendimin e KKRT-së nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010 të KKRT-së, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit, person fizik z.Erjon Keta, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

**VENDOSI:**

1. T’i japë licencë, personit fizik z.Erjon Keta, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për “TV kabllor Ergi”, për një periudhë prej 6-vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal fshatrat Rrashbull dhe Shënavlash.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**  
**Endira Bushati**

**VENDIM**  
**Nr.280, datë 30.11.2011**

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT KABLLOR**  
**“TV KABLLOR KRUJA”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit për rinovimin e licencës dhe mbështetur në propozimin e komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

**VENDOSI:**

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat kabllor “TV kabllor Kruja”, në fushën e transmetimeve televizive kabllore private.

2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.

Ky vendim i shtrin efektet nga data 21.2.2011 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**  
**Endira Bushati**



**KËRKESË**  
**Nr.7477, datë 16.12.2011**

**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurisë së paluajtshme pronë private, në truallin që ndodhet në Muzeun Historik Kombëtar “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, Krujë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Muzeu Historik Kombëtar “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, Krujë. Me anë të këtij publikimi kërkohet të vëmë në dijeni personin i cili preket nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për pronarin sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronari që ka emrin në listën emërore, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, ka të drejtë të paraqesë pretendimet e tij të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë kompetente (Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve).

Në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”, të gjithë pronarët do të shpronësohen pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Vlera totale e këtij shpronësimi është 3 480 000 (tri milionë e katërqind e tetëdhjetë mijë) lekësh.

**MINISTRI I TURIZMIT, KULTURËS, RINISË  
DHE SPORTEVE**  
**Aldo Bumçi**

**LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK TË PASURISË SË  
PALUAJTSHME PRONË PRIVATE, NË TRUALLIN QË NDODHET NË MUZEUN HISTORIK  
KOMBËTAR “GJERGJ KASTRIOTI SKËNDERBEU”, KRUIË**

Rrethi: Krujë

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: truall

Shpronësim definitiv

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. kadastral	Nr. i pasurisë	Sip. e shpronësuar në m <sup>2</sup>	Çmimi në lekë/m <sup>2</sup>	Adresa
1.	1. Myftar Kupi 2. Muharrem Kupi 3. Nderim Kupi 4. Ikbale Kupi	Ibrahim	Kupi	Truall	8621	9/110	400m <sup>2</sup>	8700 lekë për m <sup>2</sup>	Zona nr.3, lagjja “Kala”, Krujë

**KËRKESË**

Kërkuesja Bukurie Elezaj, e datëlindjes 3.6.1936, lindur dhe banuese në Tiranë, kërkon shpalljen të vdekur të shtetases Bakushe Visha.

**KËRKUESE**  
**Bukurie Elezaj**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 9.1.2012  
Doli nga shtypi më 11.1.2012

Tirazhi: 1700 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja Mediaprint  
Tiranë, 2012

Çmimi 44 lekë